

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 11167/09

Genc Bushati
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 6 prill 2023, si Komision, i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme paraqitur më 21 nëntor 2008,

duke marrë në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria përgjegjëse me anë të së cilës i kërkohej Gjykatës të çregjistronte kërkesën nga lista e kërkesave,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesi, z. Genc Bushati, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1944, i cili jeton në Shkodër, Shqipëri.

Kërkuesi bëri një ankesë në mbështetje të nenit 1, të protokollit nr. 1, pasi autoritetet nuk kishin paguar në kohë një kompensim akorduar në shkallën përfundimtare nga një autoritet administrativ në vitin 1993, në lidhje me pasurinë e luajtshme.

LIGJI

Pas negociatave miqësore të pasuksesshme, Qeveria propozoi një deklaratë të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e problematikës paraqitur në kërkesë. Gjithashtu, Qeveria i kërkoj Gjykatës të çregjistronte kërkesën nga lista e çështjeve sipas nenit 37 të Konventës.

Qeveria e pranoi shkeljen dhe ofroi t'i paguante kërkuesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur për të mbuluar dëmin pasuror dhe jo pasuror, si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të konvertoheshin në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme datën e pagesës, pa u ndikuar nga asnjë taksë. Shuma do të shlyhej brenda tre muajve nga data e shpalljes së njoftimit të marrë nga Gjykata. Nëse shuma nuk do të paguhej brenda periudhës tremujore, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj saj, që prej përfundimit të periudhës deri në shlyerjen e plotë, në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre për qind pikë. Paga do të ishte zgjidhja përfundimtare e çështjes.

Kërkuesi u përgjigj se deklarata e Qeverisë mbulonte vetëm shumën nominale të kompensimit dhe jo humbjen e përfitimeve. Ai paraqiti pretendime për shpërblim të drejtë dhe nuk i pranoi kushtet e deklaratës.

Neni 37 § 1 (c) parashikon se Gjykata mund të çregjistrojë një kërkesë nga lista e saj kur:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Në rrethana të caktuara, ajo mund të çregjistrojë një kërkesë në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) sipas një deklarate të njëanshme nga Qeveria përgjegjëse edhe nëse kërkuksi dëshiron që të vijohet me shqyrtimin e çështjes.

Për këtë arsye, Gjykata ka shqyrtuar deklaratën sipas parimeve të përcaktuara nga praktika e saj gjyqësore (shih *Tabsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI; *WAZA Sp. Z o.o. kundër Polonisë* (vendim), nr. 11602/02, 26 qershor 2007; dhe *Sulwińska kundër Polonisë* (vendim), nr. 28953/03, 18 shtator 2007).

Duke marrë në konsideratë natyrën e parashtrimeve në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila është në përputhje me shumën e akorduar në çështje të ngjashme – Gjykata është e mendimit se nuk është e justifikueshme të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 (c)).

Gjithashtu, për sa më sipër, dhe veçanërisht duke pasur në konsideratë praktikën gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me këtë tematikë, Gjykata vendos se sipas parashikimit të Konventës dhe Protokolleve të saj për të drejtat e njeriut, asaj nuk i kërkohet që të vazhdojë me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1, *in fine*).

Së fundmi, nëse Qeveria nuk përmbush kushtet në deklaratën e saj të njëanshme, kërkesa do të rikthehet në listën e çështjeve të Gjykatës në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime,

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë përgjegjëse, sipas nenit 1, të protokollit nr. 1, si edhe modalitetet që garantojnë përmbushjen e angazhimeve të referuara në atë deklaratë;

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 37 § 1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 11 maj 2023.

Viktoriya Maradudina

Zëvendësregjistrare e Përkohshme

Ioannis Ktistakis

Kryetar

SHTOJCË

KËRKESË QË NGRE ANKESA SIPAS NENIT 1, TË PROTOKOLLIT NR. 1

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkuarit	Shuma e akorduar për dëmin pasuror dhe jopasuror, dhe kostot dhe shpenzimet (në euro)
11167/09 21.11.2008	Genc BUSHATI 1944	15.7.2016	19.9.2016	4,230